



VENDIM

Nr. 38 Datë 18.03.2015

PËR

LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER”  
SH.P.K PËR LIÇENSIMIN NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË  
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, gërma “a”; 9 dhe nenit 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “P”; 5 pika 1 gërma “P”; 13 dhe 14 pika 1, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.03.2015 pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “**Albanian Energy Supplier**” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

**Konstatohet se :**

Aplikimi i shoqërisë “**Albanian Energy Supplier**” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

## Dokumentacioni i Përgjithshëm

- Neni 9, pika 1  
*Formati i aplikimit* : është plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 2  
*Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor* : është i plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 3  
*Dokumentacioni financiar dhe fiskal* është i plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 4/9 gërmat “a”, “b”, “c” *Dokumentacioni teknik*: është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë **“Albanian Energy Supplier ”sh.p.k.**, në aktivitetin e Furnizuesit të kualifikuar të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s**

**Petrit AHMETI**

